



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Prill, 2019
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Shpresa Shala, M.A

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Drejtoria e Arsimit (DA), në vazhden e punëve dhe detyrave të shumta, gjatë muajit prill të vitit 2019, ka arritur me sukses dhe rezultate të kënaqshme të realizojë punë dhe detyra të shumta, punë të parapara me planin e veprimit dhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura. Pra, realizimi i punëve dhe detyrave të planifikuara ka reflektuar në shumë dimensione progresive për proceset arsimore.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DA dhe IEAA;
- Rishikimi dhe hartimi i kriterëve për punësim;
- Rishikimi funksional i DA-së;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;

- Inicimi i formimit të Asociacionit të drejtorëve të shkollave, që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Aktivitetet rreth përcaktimit të koordinatorit të cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Monitorimi i nënshkrimit të marrëveshjeve për punë praktike në nivel shkollash;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Hartimi i politikave dhe rregulloreve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Hartimi i Plani për zhvillimin profesional të personelit mësimdhënës dhe administrativ;
- Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;
- Organizimi dhe mbajtja e "Garave të diturisë", për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i testit TIMSS 2019;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit parauniversitar (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisit Profesional);
- Organizimi i aktivitetit "Java me Dyer të Hapura", në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Organizimi i aktivitetit, "Ditët e Orientimit për Maturantë", në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina";
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2019-2020 dhe konsultime me MASHT;
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet

dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësorë në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;

- Identifikimi i nevojave të shkollave për punëtori, laboratorë/ kabinete dhe materiale shpenzuese në vit;
- Trajnimi i mësimdhënësve
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave që do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti, e të tjerë në IP me orar të organizuar sipas UA-së për numër të fëmijëve në IP;
- Shërbimet shëndetësore-pedagogjike dhe psikologjike, hartojnë plane pune të integruara sipas nevojave dhe kërkesave të IP-ve;
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Vlerësimi i tenderit për furnizimi me xhama;
- Vlerësimi i tenderit “ Furnizimi me kabinete, fizikë, kimi dhe biologji”;
- Mbledhja e të dhënave për furnizim me tekste shkollore për klasat 1-9;
- Përgatitja e lëndës dhe dërgimi në prokurim i projektit “ Furnizimi me material didaktik i institucioneve arsimore”;
- Përgatitja e lëndës dhe dërgimi në prokurim i projektit “ Furnizimi me materiale pedagogjike për institucionet arsimore”;
- Furnizimi me material higjenik i shkollave;
- Furnizimi me material didaktik i disa shkollave;
- Furnizimi i nxënësve të nivelit të arsimit fillor me kifile;
- Përgatitja e projektit për furnizim me libra i bibliotekave shkollore etj.
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përcjella dhe realizimi projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;

- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me Freebalance;

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik, janë duke operuar në terren dhe duke e përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, këshilluese, speciale dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë muajit prill të vitit 2019, kanë realizuar planin e punës. Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar **26 vizita informuese, 9 vizita këshilluese** në institucionet e nivelit të arsimit të mesëm të lartë, në: SHML “Sami Frashëri”, SHML “Xhevdet Doda”, SHML “Ahmet Gashi”, SHML “Gjin Gazulli”, SHML “7 Shtatori”, SHML “28 Nëntori”, SHML “Hoxhë K. Prishtina”, SHML “Dr. Ali Sokoli” dhe SHML “Abdyl Frashëri”, dhe vizitë speciale në shkollën fillore “Hasan Prishtina” dhe gjimnazin “Sami Frashëri”.
- Drejtoria e Arsimit, në funksion të zhvillimeve dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka zgjedhur koordinatoren e cilësisë në nivel komune dhe njëkohësisht ka arritur t’i zgjedhë 17 koordinatore të shkollave dhe në vijimësi është duke bërë përpjekje që në secilën shkollë të emërohet koordinatori i cilësisë, pedagogë të përgjithshëm apo mësimdhënës kompetentë për këtë detyrë;
- Për të trajtuar çështje të ndryshme rreth zhvillimeve reformuese që janë duke u zhvilluar në sistemin e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës, në udhëheqjen e Drejtores së Arsimit znj. Shpresa Shala, më 10 prill 2019. U mbajt takimi i radhës i Ekipit profesional në nivel komune, për mbështetjen e institucioneve edukativo-arsimore rreth implementimit dhe zbatimit në



praktikë të kurrikulës së re.

Të pranishëm në këtë takim ishin edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, konkretisht përfaqësuesit e divizionit të kurrikulës, znj. Shqipe Gashi dhe z. Arbër Salihu, të cilët dhanë kontribut të çmueshëm në këtë takim, duke trajtuar në mënyrë profesionale pika të ndryshme rreth zbatimit në praktikë të kurrikulës së re dhe shpreh gatishmëri për të mbështetur ekipin tonë në shumë dimensione, në vazhdimësi.

Andaj, në funksion të implementimit të politikave reformuese që janë duke u zhvilluar në sistemin e arsimit parauniversitar të vendit tonë, kërkohet mobilizim dhe bashkëpunim i vazhdueshëm profesional në mes institucioneve lokale dhe qendrore, në mënyrë që ndryshimeve reformuese t'ju përgjigjem me kompetencë dhe profesionalizëm të lartë, duke lehtësuar implementimin në praktikë të KK-së, në institucionet arsimore.

Ekipi profesional në nivel komune, në mënyrë permanente është duke ofruar mbështetje profesionale për të gjithë të përfshirët në procesin arsimor, rreth implementimit të kurrikulës së re, duke mundësuar që ky dokument zyrtar të gjejë zbatim në institucione tona, sipas standardeve dhe kërkesave të kërkuara.

Është indikativ fakti, se puna dhe angazhimi i Ekipit profesional në nivel komune, ka reflektuar pozitivisht në shumë dimensione dhe veçanti ka lehtësuar implementimin e kurrikulës për mësimdhënësit, andaj mbështetja në këtë segment do të jetë permanente deri në arritjen e qëllimit të synuar.

- **Bashkëpunimi, mekanizëm i fuqishëm për avancimin e proceseve reformuese që janë duke u zhvilluar në sistemin e arsimit parauniversitar**

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, pas vlerësimit të përgjithshëm mbi gjendjen e reformave që janë duke u zhvilluar në sistemin e arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe veçanti zbatimin në praktikë të kurrikulës së re, ka identifikuar se në këtë segment ka nevojë për mbështetje profesionale dhe në mënyrë permanente nga institucionet e nivelit qendrore dhe atij lokale. Andaj, DA-ja për t'ju përgjigjur këtyre zhvillimeve reformuese që janë duke u zhvilluar në sistemin e



arsimit parauniversitar, ka ndërmarë veprime konkrete në shumë dimensione, në mënyrë që proceset e filluara të gjejnë zbatueshmëri të duhur në institucionet tona. Në funksion të këtyre zhvillimeve DA-ja, në koordinim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, kanë hartuar planin e bashkëpunimit në mes shkollave-

mësimdhënësve për vitin shkollor 2018-2019, duke inkorporuar tema esenciale të cilat janë determinuese për mbështetjen e proceseve reformuese, që janë duke u zhvilluar në sistemin e arsimit parauniversitar.

Prandaj, gjatë muajit prill 2019, në funksion të këtyre proceseve arsimore u zhvilluan takimi bashkëpunuese në të gjitha qendrat e caktuara nga Drejtoria e Arsimit, ku në këto takime kanë marrë pjesë gjithë edukatorët dhe mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të larta, konkretisht mësimdhënësit që janë duke e zbatuar në praktikë kurrikulën e re. Andaj, në mënyrë që takimet e bashkëpunimit të rrjedhë sipas standardeve dhe kërkesave të parapara, në secilën fushë të kurrikulës janë caktuar trajnerë kompetentë dhe profesionalë për mbështetje të mësimdhënësve me këshilla profesionale;

- Po ashtu, mësimdhënësit në këto takime bashkëpunuese janë vizituar vazhdimisht nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit, konkretisht nga drejtoresha e arsimit znj. Shpresa Shala, për t'i inkurajuar dhe mbështetur mësimdhënësit në këtë proces. Pra, me këtë plan dinamik rol kyç do të jetë forcimi dhe bashkëpunimi në mes shkollave, mësimdhënësve dhe aktiveve profesionale (seksioneve) të shkollave, duke u mobilizuar për procese progresive, sepse mësimdhënësit janë promotor të këtyre zhvillimeve reformuese. Andaj, bashkëpunimi në mes shkollave, aktiveve apo fushave të kurrikulës do të jenë të koordinuar mirë, në mënyrë që proceseve reformuese t'ju përgjigjemi bashkërisht dhe në mënyrë profesionale. Po ashtu, duhet theksuar se mësimdhënësit tonë po tregojnë përkushtim të madh, që kurrikula e re në institucionet tona të gjen zbatueshmëri, sipas kërkesave dhe standardeve të kërkuara, sepse përmes këtij dokumenti zyrtar po synojmë të ndërtojmë një sistem të mirë të arsimit dhe të harmonizojmë sistemin e arsimit të Kosovës, me sistemin e arsimit të shteteve të zhvilluara evropiane, duke ngritur dhe përmirësuar edhe cilësinë në mësimdhënie dhe mësim-nxënie.



Panairi i edukimit

Drejtorja e Arsimit, në koordinim me kompaninë CEO-Congress and Event



on, gjatë muajit prill 2019, kanë realizuar aktivitetin Panairin e Edukimit. Ky aktivitet është realizuar në kuadër të përpjekjeve të DKA-së, për sensibilizimin e nxënësve të klasës së IX-të për orientim sa më të suksesshëm në karrierë, si dhe promovim të profileve të shkollave profesionale, duke iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të tregut të punës. Andaj, në këtë aktivitet të gjitha shkollat e mesme të larta nga data **16 - 17 prill 2019, në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë**, kanë prezantuar drejtimet që ato ofrojnë, kushtet dhe praktikat që ata i ofrojnë.

Kështu që, prezantim është realizuar para një audience të madhe, të nxënësve të klasave të IX-ta dhe maturantë të klasave të XII-ta, prindër, përfaqësues të shkollave. Po ashtu, në këtë panair prezent ishin edhe përfaqësues të universiteteve të ndryshme të cilët prezantuan programet e tyre.

Pra, qëllimi i “Panairit të Edukimit” është që nxënësit të informohen për shkollat profesionale dhe të orientohen nga aftësimi profesional, si një mundësi më e madhe për qasje në tregun e punës.



t

Takim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore

Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit prill të vitit 2019, ka vazhduar procesin e takimeve me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, ku këtë vit është duke u aplikuar një format apo strategji e re takimeve. Pra, takimet janë realizuar me grupe më të vogla, veprim që ka reflektuar pozitivisht në shumë dimensione sepse ka dhënë hapësirë dhe mundësi më të madhe për secilin për t’u trajtuar çështjet e ndryshme me gjerësisht dhe në mënyrë profesionale. Në këtë takime, me theks të veçantë janë trajtuar çështjet,



mbarëvajtja dhe ecuria e procesit edukativo-arsimor në të gjitha dimensionet, funksionimi i organeve dhe mekanizmave të brendshme të shkollës dhe bashkëpunimin në mes drejtuesve të shkollave e mësimit në mes të shkollave të caktuara, rreth implementimit dhe zbatimit në praktikë të KK-së;

- **Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**, gjatë muajit prill, organizuan manifestimin “Java me dyer të Hapura”.

Ky projekt ka për qëllim orientimi në karrierë të nxënësve dhe iu dedikohet nxënësve të klasës IX. Duke organizuar vizita në institucionet e arsimit të mesëm të lartë (shkolla profesionale dhe gjimnaze) dhe disa aktivitete të ndryshme informuese për nxënësit, aktivitete të cilat ndihmojnë nxënësit në zgjedhjen e drejtimeve të tyre në arsimin e mesëm të lartë.

Andaj, nga data **23 deri më 26 prill 2019**, në Komunë e Prishtinës të gjitha institucionet e arsimit të mesëm të lartë (profesionale dhe gjimnaze), kanë realizuar projektin e dyerve të hapura dhe kanë pritur nxënësit, prindërit dhe u kanë prezantuar dhe informuar për shkollën e tyre;

- **Drejtoria e Arsimit, në koordinim me Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”**, nga data 24 deri më 26 prill 2019, organizuan aktivitetin, “Ditët e Orientimit për Maturantë”. Ky aktivitet orientues për nxënësit është mbështetur edhe nga Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe Busulla - portali zyrtar i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për orientim profesional, edukim dhe këshillim në karrierë.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte njohja e maturantëve për së afërmi me mundësitë e studimeve në Universitetin e Prishtinës, ku nga përfaqësuesit e njësive akademike dhe përfaqësues të tjerë të arsimit të lartë, janë prezantuar këto mundësi para maturantëve;

- **Panairi i Edukimit, i organizuar nga Qendra e Karrierës**

Për tri ditë në Prishtinë u mbajt “Panairi i Karrierës”, ku nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave fillore kanë pasur mundësi të informohen për shkollat e mesme profesionale që janë në kryeqytet. Qëllimi i këtij panairi është që nxënësit të informohen për shkollat profesionale dhe të orientohen nga aftësimi profesional, si një mundësi më e madhe për qasje në tregun e punës. Në Qendrën e Karrierës në Prishtinë, tetë shkolla profesionale kanë prezantuar drejtimet që ato ofrojnë, kushtet dhe praktikën që ata i ofrojnë. Në panair janë prezantuar shkollat: "Dr Ali Sokoli", "Hoxhë Kadri Prishtina", "28 Nëntori", "Gjin Gazulli", "7 Shtatori", "Prek Jakova", "Abdyl Frashëri" dhe "Shtjefën Gjeqovi”.

- Aktivitetet profesionale (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë kësaj periudhe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara dhe në fund muajit kanë përgatitë raporte mbi ecurinë dhe zhvillimet e përgjithshme në shkollë. Po ashtu, aktivitetet profesionale në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë dhe mentoruar nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa Drejtoria e Arsimit në vazhdimësi i ka mbështetur me këshilla profesionale, aktivitetet profesionale dhe i ka informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit dhe u ka përgatitë formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj. Ndërsa, shkollat për punët e realizuara nga aktivitetet gjatë periudhës së dytë kanë raportuar në DA;
- Organizimi i testit “TIMSS 2019”, TIMSS (Trends in International Mathematics and Science Study) është Test ndërkombëtar i prirjeve në Matematikë dhe Shkencë për vlerësimin e nxënësve. Ky test matë arritjet e nxënësve të klasëve të 4-ta dhe të 8-ta.

Në nivel vendi, iu nënshtruan testit rreth 5000 nxënës/e, ndërsa në nivel komune afërsisht 600 nxënës/e të klasave të 4-ta.

- Mësimi jo formal në të tri nivelet e arsimit parauniversitar është duke u realizuar sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimi joformal është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe në një institucion të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët, ky proces në këto institucione është duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këtë periudhë kohore janë vlerësuar nga ekipi vlerësues tre (3) nxënës-fëmijë. Andaj, njëra nga këta nxënës ka qenë nga një shkollë private, e cila ka pasur kryesisht probleme emocionale, një me probleme në të dëgjuar dhe një me Sindrom Down. Që të tri rastet janë referuar në shkolla të rregullta.
- Realizimin e praktikës profesionale me nxënësit e shkollave profesionale, gjatë muajit prill është realizuar në një masë, por jo në nivel të kënaqshëm, kjo është si pasojë e disa faktorëve, si: mos gatishmëria e bizneseve për pranim të nxënësve, mungesa e transportit etj. Pra, është indikativ fakti se praktika profesionale për nxënësit e shkollave profesionale është determinuese, në zhvillimin dhe përgatitjen e tyre profesionale;
- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;
- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhunë apo shkelje të të drejtave të fëmijëve - nxënësve në institucionet arsimore, Drejtoria merr masa të menjëhershme komform legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe rregullores komunale për arsim;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Drejtoria e Arsimit, për vitin akademik 2018-2019, ka shpallur konkurs për ndarjen e 120 bursave, për studentët e komunës së Prishtinës të cilët studiojnë në universitetet publike;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit janar;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga dy përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Furnizimi i institucioneve arsimore të nivelit fillor (I-V) me kifile;
- Është realizuar vlerësimi i tenderit për furnizim me xhama të institucioneve edukativo-arsimore;

- Është realizuar vlerësimi i tenderit për furnizim me kabinete të fizikës, kimisë dhe të biologjisë për shkolla;
- Janë mbledhur të dhënat për furnizim me libra shkollor për klasat I-IX dhe janë dërguar të dhënat në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Është dërguar në prokurim projekti për furnizim të institucioneve arsimore me material didaktik;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime të tjera;
- Gjashtë intervista për media

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Aktivitetet rreth formimit të asociacionit të drejtorëve të shkollave, që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Hartohen politika dhe rregullore për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve;
- Hartohet Plani për zhvillimin profesional të personelit mësimitdhënës dhe administrativ;
- Përcjellja e shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Transporti për nxënës dhe arsimtarë;
- Menaxhimi i kontratave për mallra dhe shërbime;
- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet shkollore;
- Kontrollimi i shpenzimeve(subvencioneve), në Institucionet parashkollore me bazë në komunitet.

3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës

3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese prill-2019;

Buxheti i shpenzuar dhe alokuar 04-2019				
Kategoria Eko.	Alokim	Shpenzim	Zotim - Obligim	Mbetje -S=
Paga	1,597,799.65	1,597,799.65	-	-
Komunali	417,999.99	386,250.93	-	31,749.06
10-MSH	599,579.47	243,153.80	73,501.09	282,924.58
21-MSH	199,0000.00	179,402.49	-	19,597.51
Subvencione	70,000.00	38,575.00	-	31,425.00
Donacione	4,000.00	1,864.00	-	2,136.00
FB-21-Kapitale	404,412.80	126,0000.00	54,391.00	224,021.80
FB-22-Kapitale	-	-	-	-
Totali:	3,292,791.91	2,573,045.87	127,892.09	591,853.95

3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit prill ka realizuar mbi 145 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

4. Takimet me institucione të tjera

Gjatë periudhës raportuese, prill 2019, janë realizuar takime me:

- zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- përfaqësuesit e Bonevet;
- përfaqësuesit e Save the Children;
- përfaqësuesit ASSET-USAID;
- përfaqësuesit e bankës Raiffeisen;
- përfaqësuesit e LUX-DEV;
- përfaqësuesit e EU;
- përfaqësuesit e ambasadës turke;
- ambasadorin e Shqipërisë;
- me auditorë;
- Inspektorët e arsimit;
- përfaqësuesit e KUR “Prishtina”;
- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e PTT.

4.1.1. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Gjatë muajit prill, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit prill janë pranuar gjithsej 75 lëndë, prej tyre të miratuara janë 20, të refuzuara 14 lëndë, të pezulluara 10, të anuluar 1 dhe në proces janë 30 lëndë, por duhet theksuar se 15 lëndë janë ankesa për bursa.

6. Takime të tjera:

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës;
- Takim me përfaqësues të prindërve të shkollave të caktuara;
- Takim me përfaqësuesit e Qendrës së Karrierës;
- Takim me drejtorin e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik;
- Takim me drejtorët rajonal të drejtorive të Arsimit;
- Takim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Parqeve.

7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi, përgjegjësi, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Kushtet jo optimale të punës për stafin e Drejtorisë së Arsimit, gjë që po reflekton drejtpërdrejt në cilësinë dhe realizimin e punëve dhe detyrave;
- Implementimi i kurrikulës së re.

8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësi, punëve dhe detyrave që ka;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të Komunës së Prishtinës.

9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Krijimi i ekipit profesional në nivel të DA-së për monitorimin e përkrahjen e vlerësimit të performancës së shkollës;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;
- Formohet asociacioni i drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Sigurohet koordinatori i cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurohet buxheti adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësuesit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për ZHPM;
- Organizimi dhe mbajtja e "Garave të diturisë", për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisë Profesionale);
- Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin e mesëm;
- Organizimi i diskutimeve publike rreth regjistrimit në vitin shkollor 2019-2020 dhe konsultime me MASHT;

- Hartimi i propozimit për MASHT për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme në vitin shkollor 2019/2020;
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Organizohen punëtori të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatim i monitorimit të zbatimit të kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP;
- Krijim i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimeve për zbatim të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimeve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurohen dhe menaxhohen fondet për përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohet pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Tenderimi i kompanisë për furnizim;
- Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut në shkollë;
- Hartohen listat për nevojat e secilës shkollë për punëtori, kabinete /laboratorë dhe materiale shpenzuese;
- Tenderimi i kompanive dhe pajisja e shkollave me punëtori, laboratorë / kabinete dhe materiale shpenzuese;
- Trajnimi i mësimeve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave, të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Hartohet programi i investimeve në infrastrukturën e edukimit parashkollor në Prishtinë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti, e të tjerë në IP me orar të organizuar sipas UA-së për numër të fëmijëve në IP;
- Krijimi i një ekipi komunal (zyrtar të arsimit, zyrtar të inspeksionit sanitar, infrastrukturë, profesionistë të fushës, etj.) për organizimin e monitorimit, mbikëqyrjes, kontrollit të zbatimit të standardeve të EPSH (këshillohet që ky ekip të mos merret vetëm si inspektim, por edhe si këshillues e përkrahës – në të përfshihen edhe profesionistë – ekspertë; nuk është mirë të duplikohet inspektimi);

- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësime të gabuara që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektive;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonim;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përcjella dhe realizimi projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me Freebalance;
- Përgatitja e projektit për furnizim me pajisje teknologjike të shkollave etj.

10. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme

N/A